



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORE

Nr. 2431 Prot.

Vlorë, më 10/06/2026

**Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ**

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Departamentit Ekonomik dhe Burimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Aseteve dhe Burimeve Mbështetëse

Sektorit të Zgjidhjeve dhe Suportit Help Desk

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj shpalljen publike të pesë akteve administrativ (bashkëngjitur) – Vendimet e kontabilizimit të detyrimeve doganore si vijon :

1. Nr.156, me Nr.1053/3 Prot., datë 16/07/2026, i materializuar ndaj subjektit “JURI.” sh.p.k, me NIPT K06705213T, me seli në Vlorë (Lagjia “Pavarësia”, Rruga “Transballkanike”, Pallati te nënstacioni elektrik, Kati 1).
2. Nr.159, me Nr.1053/4 Prot., datë 16/07/2026, i materializuar ndaj subjektit “JURI.” sh.p.k, me NIPT K06705213T, me seli në Vlorë (Lagjia “Pavarësia”, Rruga “Transballkanike”, Pallati te nënstacioni elektrik, Kati 1).
3. Nr.161, me Nr.1876/4 Prot., datë 16/07/2026, i materializuar ndaj subjektit “Erlind Hasanaj”, me NID J50416050D, me banim në Vlorë.
4. Nr.166, me Nr.2324 Prot., datë 05/08/2026, i materializuar ndaj subjektit “MAGS SHOES” sh.p.k, me NIPT L66412202O, me seli në Vlorë (Lagjia “Rilindja”, Rruga “Riza Salati”, Godinë 4 katëshe; me adresë elektronike E-Mail: [magsshoes4@gmail.com](mailto:magsshoes4@gmail.com)).


5. Nr.167, me Nr.2325 Prot., datë 05/08/2026, i materializuar ndaj subjektit “MAGS SHOES” sh.p.k, me NIPT L66412202O, me seli në Vlorë (Lagjja “Rilindja”, Rruga “Riza Salati”, Godinë 4 katëshe; me adresë elektronike E-Mail: magsshoes4@gmail.com).

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes publike të pesë akteve të larcituar.

*Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,*

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.1053/3 Prot.

Vlorë, më 16/07/2026

**VENDIM Nr.156**

Sot, më datë 16/07/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe shkresën Nr.1053/1 Prot., datë 13.07.2026 me lëndë "Proces Verbal" (Për mallin e deklaruar me DAV Nr. R 5492, datë 20/04/2023), i mbajtur nga ana e Grupit të Kontrollit pranë Degës së Doganës Vlorë ndaj subjektit "JURI." sh.p.k, me NIPT K06705213T, me seli në Vlorë (Lagjia "Pavarësia", Rruga "Transballkanike", Pallati te nënstacioni elektrik, Kati I),

**K O N S T A T O V A S E :**

Pranë Degës së Doganës Vlorë, është paraqitur subjekti "JURI." sh.p.k, me NIPT K06705213T, i përfaqësuar nga Agjensia Doganore "Gad.Universi" me kod J 102, për të deklaruar vendosjen në qarkullim të lirë të mallit të Tij, me deklaratën doganore IM.4 me numër R 5492, datë 20/04/2023, me të cilën nga ana e subjektit është deklaruar artikulli nr.9 "Insekticid 450 gr 1200 copë", pesha neto 540 kg, deklaruar në kodin tarifor \*38089190\*.

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, është ushtruar auditimi i përputhshmërisë ligjore në bazë të Programit të Auditimit nr.427/1 prot., datë 14.04.2025, për periudhën kohore 01.01.2023 - 31.12.2024. Në përfundim të auditimit, nga ana e organit konstues (KLSH) është mbajtur Akt Konstatimi Nr.11, administruar në sekretarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me nr.22739 Prot., datë 10/11/2025, i cili është përcjellë në Degën e Doganës Vlorë administruar me nr.2428/2 Prot., datë 17/11/2025.

Më tej, nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave shkresa me Nr.427/117 Prot., datë 19/03/2026, me lëndë "Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për "Auditim përputhshmërie", administruar në sekretarinë e D.P.D-së me nr.504/66 Prot., datë 26/03/2026, përcjellë pranë Degës së Doganës Vlorë (administruar në sekretarinë tonë me nr.159/1 Prot., datë 31/03/2026).

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, me anë të Urdhërit Nr.7504/72 Prot., datë 05.05.2026, Dega e Doganës Vlorë, është ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ana e KLSH, me anë të Raportit Përfundimtar të lartcitur.

Paraprakisht, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar me shkresën Nr.3535 Prot., datë 27.11.2025, me lëndë "Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative" dhe më tej, me shkresën nr.1053 Prot., datë 09/04/2026, me lëndë "Dërgim informacioni mbi përfundimin e procedurës hetimore administrative dhe kërkesë për paraqitje kundërshtimesh me shkrim", ku Dega e Doganës Vlorë ka ftuar subjektin të shprehej me shkrim përpara marrjes së vendimit përfundimtar, mbi konstatimin/rekomandimin e mbajtur nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në zbatim të legjislacionit doganor nga ana e grupit të kontrollit pranë Degës së Doganës Vlorë, është proceduar me marrjen në shqyrtim të rekomandimit të K.L.SH për deklaratën doganore të lartcituuar, në përfundim të të cilit, kanë konkluduar se rekomandimi është i drejtë dhe për këtë fakt kanë mbajtur shkresën Nr.1053/1 Prot., datë 13.07.2026 me lëndë "Proces Verbal", ku midis të tjerave kanë arsyetuar si vijon : *"Pas marrjes në shqyrtim të deklaratës doganore IM.4, me të cilën nga ana e subjektit "JURI." sh.p.k, me NIPT K06705213T, përfaqësuar nga Agjensia Doganore "Gad.Universi" me kod J 102, është deklaruar artikulli nr.9 (malli) "Insekticid 450 gr 1200 copë", klasifikuar në kreun \*3808\* të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave. Ky artikull është deklaruar nga ana e subjektit me çmimin më të ulët se vlera referuese e të njëjtit grup. Duke marrë në konsideratë praktika të ngjashme të zhdoganuara për mallra të ngjashme, konstatohet se është ndjeshëm më ulët se vlera minimale e grupit ku klasifikohet artikulli "insekticide". Referuar praktikës doganore me nr. R 10470 datë 20.07.2023 të Degës së Doganës Vlorë të njëjtit subjekt, artikulli "insekticide" është zhdoganuar me vlerën 4290\$/ton, andaj praktikat si më poshtë do të rivlerësohen sipas 4290\$/Ton".*

Për sa më lart, mbështetur në kreun III "Vlera për qëllime doganore" neni 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 "Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore" të Ministrit të Financave,

#### V E N D O S A :

- Subjekti "JURI." sh.p.k, me NIPT K06705213T, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **8,462** (tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, për deklaratën doganore IMP. 4 me numër R 5492, datë 20/04/2023.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Kontrollit Aposterior të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës 1 të Vendimit.
- Kundër këtij vendimi, subjektit "JURI." sh.p.k, me NIPT K06705213T, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar).

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.1053/4 Prot.

Vlorë, më 17/07/2026

**VENDIM Nr.159**

Sot, më datë 17/07/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe shkresën Nr.1053/2 Prot., datë 13.07.2026 me lëndë "Proces Verbal" (Për mallin e deklaruar me DAV Nr. R 8586, datë 16/06/2023), i mbajtur nga ana e Grupit të Kontrollit pranë Degës së Doganës Vlorë ndaj subjektit "JURI." sh.p.k, me NIPT K06705213T, me seli në Vlorë (Lagjia "Pavarësia", Rruga "Transballkanike", Pallati te nënstacioni elektrik, Kati 1),

**KONSTATOVA SE:**

Pranë Degës së Doganës Vlorë, është paraqitur subjekti "JURI." sh.p.k, me NIPT K06705213T, i përfaqësuar nga Agjensia Doganore "Gad.Universi" me kod J 102, për të deklaruar vendosjen në qarkullim të lirë të mallit të Tij, me deklaratën doganore IM.4 me numër R 8586, datë 16/06/2023, me të cilën nga ana e subjektit është deklaruar artikulli nr.7 "Insekticid 450 gr 2400 copë", pesha neto 1,080 kg, deklaruar në kodin tarifor \*38089190\*.

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, është ushtruar auditimi i përputhshmërisë ligjore në bazë të Programit të Auditimit nr.427/1 prot., datë 14.04.2025, për periudhën kohore 01.01.2023 - 31.12.2024. Në përfundim të auditimit, nga ana e organit konstues (KLSH) është mbajtur Akt Konstatimi Nr.11, administruar në sekretarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me nr.22739 Prot., datë 10/11/2025, i cili është përcjellë në Degën e Doganës Vlorë administruar me nr.2428/2 Prot., datë 17/11/2025.

Më tej, nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave shkresa me Nr.427/117 Prot., datë 19/03/2026, me lëndë "Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për "Auditim përputhshmërie", administruar në sekretarinë e D.P.D-së me nr.504/66 Prot., datë 26/03/2026, përcjellë pranë Degës së Doganës Vlorë (administruar në sekretarinë tonë me nr.159/1 Prot., datë 31/03/2026).

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, me anë të Urdhërit Nr.7504/72 Prot., datë 05.05.2026, Dega e Doganës Vlorë, është ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ana e KLSH, me anë të Raportit Përfundimtar të lartcitur.

Paraprakisht, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar me shkresën Nr.3535 Prot., datë 27.11.2025, me lëndë "Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative" dhe më tej, me shkresën nr.1053 Prot., datë 09/04/2026, me lëndë "Dërgim informacioni mbi përfundimin e procedurës hetimore administrative dhe kërkesë për paraqitje kundërshtimesh me shkrim", ku Dega e Doganës Vlorë ka ftuar subjektin të shprehej me shkrim përpara marrjes së vendimit përfundimtar, mbi konstatimin/rekomandimin e mbajtur nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në zbatim të legjislacionit doganor nga ana e grupit të kontrollit pranë Degës së Doganës Vlorë, është proceduar me marrjen në shqyrtim të rekomandimit të K.L.SH për deklaratën doganore të lartcitur, në përfundim të të cilit, kanë konkluduar se rekomandimi është i drejtë dhe për këtë fakt kanë mbajtur shkresën Nr.1053/2 Prot., datë 13.07.2026 me lëndë "Proces Verbal", ku midis të tjerave kanë arsyetuar si vijon : *"Pas marrjes në shqyrtim të deklaratës doganore IM.4, me të cilën nga ana e subjektit "JURI." sh.p.k, me NIPT K06705213T, përfaqësuar nga Agjensia Doganore "Gad.Universi" me kod J 102, është deklaruar artikulli nr.7 (malli) "Insekticid 450 gr 2400 copë", klasifikuar në kreun \*3808\* të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave. Ky artikull është deklaruar nga ana e subjektit me çmimin më të ulët se vlera referuese e të njëjtit grup. Duke marrë në konsideratë praktika të ngjashme të zhdoganuara për mallra të ngjashme, konstatohet se është ndjeshëm më ulët se vlera minimale e grupit ku klasifikohet artikulli "insekticide". Referuar praktikës doganore me nr. R 10470 datë 20.07.2023 të Degës së Doganës Vlorë të njëjtit subjekt, artikulli "insekticide" është zhdoganuar me vlerën 4290\$/ton, andaj praktikat si më poshtë do të rivlerësohen sipas 4290\$/Ton".*

Për sa më lart, mbështetur në kreun III "Vlera për qëllime doganore" neni 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 "Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore" të Ministrit të Financave,

#### V E N D O S A :

- Subjekti "JURI." sh.p.k, me NIPT K06705213T, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **18,990** (tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë, për deklaratën doganore IMP. 4 me numër R 8586, datë 16/06/2023.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Kontrollit Aposterior të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës 1 të Vendimit.
- Kundër këtij vendimi, subjektit "JURI." sh.p.k, me NIPT K06705213T, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar).





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1876/4 Prot.

Vlorë, më 22/07/2026

V E N D I M Nr.161

Sot, më datë 22/07/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova materialin e plotë (bashkëngjitur), i mbajtur në ngarkim të subjektit “**Erlind Hasanaj**” p.f me NID J50416050D, i lindur dhe banues në Vlorë,

**K O N S T A T O V A S E :**

Më datën 28/06/2026, nga ana e Degës së Doganës Vlorë, në bashkëpunim me Grupin e Antikondrabandës Tokësore nr.16 dhe Policinë Kufitare dhe Migracionit Vlorë, është ushtruar kontroll në vijën e dytë të zonës doganore/kufitare. Gjatë kontrollit të ushtruar është konstatuar se në mjetin tip kamion me targa AB407TT kishte mallra akcize të padeklaruara. Për këtë konstatim, nga ana e grupit të kontrollit janë mbajtur aktet shkresore në vijim :

- Proces Verbal kontrolli fizik / verifikimi me numër serial 0019136, nr.1876/1 Prot., datë 29/06/2026, në të cilin është kryer përshkrimi dhe verifikimi i situatës si vijon : *“Gjatë kontrollit në pikën e kontrollit kufitar në bashkëpunim me strukturat e Policisë Kufitare dhe strukturën e grupit të antikondrabandës nr.16, në brendësi të mjetit tip kamion me targë AB407TT, me drejtues shtetasin Erlind Hasanaj, me nr. Personal ID J50416050D, u konstatuan mallra akcize të padeklaruara të llojit “Verë e kuqe 48 shishe = 750 ml – 16% SangueNero. Mallrat do të qëndrojnë të bllokuara në pritje të vijimit të procedurave doganore”.*
- Evidenca e Kontrollit Fizik me numër serial 0001912, me nr.1876/2 Prot., datë 29/06/2026, në të cilën janë pasqyruar artikujt e akcizës (pije alkolike) të konstatuara pa pullë fiskale, konkretisht, artikulli “Verë e kuqe 48 shishe = 750 ml – 16% SangueNero – 48 shishe”.
- Proces verbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative me numër serial 0007883, me nr.1876 Prot., datë 29.06.2026, në të cilin është kryer përshkrimi i shkeljes doganore si vijon : *“Gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin me targë AB407TT u konstatuan mallra akcize të padeklaruara dhe të pashoqëruara me faturat përkatëse. U mbajtën proces vrebalet përkatës dhe iu dërguan sektorit të vlerës qendër për përlllogaritje detyrimi. Subjekti do të penalizohet sipas neneve 266/2, 268/2 dhe 269/1 për rastet e përsëritura të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”.*



Nga shqyrtimi i akteve të autoritetit doganor rezulton se konstatimi lidhet me gjetjen e mallrave të akcizës të padeklaruara, të papajisura me pullë akcize dhe pa dokumentacion shoqërues (faturë tatimore apo dokument tjetër tregtar që provon origjinën dhe pronësinë e mallit).

Subjekti shkelës, si palë e interesuar në procedimin administrativ, rezulton se ka pasur të gjithë informacionin e duhur rreth procedimit administrativ që po zhvillohej ndaj tij, rreth shkeljes doganore që i atribuohet dhe pasojat ligjore që është dënuar me penaltetin përkatës në shumën e gjashtëfishit të detyrimit fiskal (pasi është subjekt përsëritës) të papaguar dhe me sekuestrimin e mallit.

Është fakt se autoriteti konstatues, i cili zotëron të drejtën t'i kërkojë subjektit të paraqesë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm, ka proceduar në rastin konkret lidhur me saktësimin dhe verifikimin e dokumentacionit të subjektit, inventarizimin e plotë të mallrave të akcizës që ishin gjendje në mjetin e transportit etj.

Subjekti shkelës, i cili ka patur detyrimin ligjor që të bindë autoritetin konstatues si dhe atë vendimmarrës, në paraqitjen e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të nevojshëm për të hequr çdo dyshim dhe për të vërtetuar me anë të dokumentacionit ligjor të drejtën e tij për ushtrimin në mënyrë korrekte transportimin e mallit "Verë", në momentin e konstatimit, nuk i'u ka mundur autoriteteve doganore një informacion të tillë.

Konstatohet se në rastin konkret kemi të bëjmë me mall akcize parashikuar në nenin 2, pika 2 dhe 3 e Ligjit nr.61/212 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" - *"Akcizë" është një taksë që zbatohet mbi produktet e akcizës, të prodhuara dhe të importuara, që hidhen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë.* Neni - 3 *"Produkte që i nënshtrohen akcizës janë : a) produktet energjetike; b) alkooli dhe pijet alkoolike; c) duhani e produktet e duhanit; ç) produktet e tjera, të përcaktuara nga ky ligj.*

Ka rezultuar se nga ana e subjektit, nuk është vepruar në përputhje me legjislacionin doganor, pasi është provuar fakti se në mjetin e tij të transportit, i është gjendur një sasi malli akcize (48 shishe verë - i pasqyruar në aktet e lartcituara) pa pulla fiskale, gjë e cila bie ndesh me legjislacionin doganor.

Neni 250 i Kodit Doganor i cituar si neni i shkelur : 1. *Shkelje doganore janë: a) kundërvajtjet administrative doganore; b) kontrabanda.*

– Neni 250/3 – *"Kontrabandë janë veprat penale të sanksionuara në Kodin Penal që cenojnë marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave ekonomike të saj, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenet 266 dhe 267 të këtij Kodi.*



Neni 266 i Kodit Doganor “Raste të kontrabandës”, parashikon : *Konsiderohet kontrabandë: 2. Futja apo nxjerrja e mallrave në ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pa i paraqitur ato tek autoritetet doganore, sipas përcaktimeve të neneve 130, 218 ose pikës 2, të nenit 239;*

Neni 268 i Kodit Doganor “Sanksionet administrative për kontrabandën” parashikon :

- 1. Autoritetet doganore vendosin sekuestro të përkohshme për mallrat që janë objekt i kontrabandës, përfshirë edhe mallrat që nuk tatohen.*
- 2. Autoritetet doganore vendosin sanksione administrative për rastet e kontrabandës në masën trefish të shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që janë objekt kontrabande, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në Kodin Penal;*
- 3. Çdo shkelës përgjigjet personalisht dhe solidarisht për pagesën e sanksionit të mësipërm, në varësi të shkallës së pjesëmarrjes. Në këtë rast, secili prej tyre është i detyruar të përmbushë tërësisht detyrimet dhe autoritetet doganore mund të kërkojnë pagesën ose të padisin njërin ose/dhe të gjitha palët.*

Neni 269 i Kodit Doganor “Përsëritja dhe tentativa” parashikon : *1. Në rastet e përsëritjes së kontrabandës (recidivism), sanksioni administrativ është dyfishi i sanksionit të përcaktuar në nenin 268. Ky sanksion nuk zbatohet nëse kanë kaluar 5 vjet nga data e pagesës së plotë të detyrimeve dhe të sanksionit të parë.*

Në përfundim, pas shqyrtimit të plotë të materialit të mësipërm, rezulton e provuar shkelja doganore “kontrabandë”, parashikuar nga Ligji nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar). Në mungesë të dokumentacionit justifikues nga subjekti dhe për shkak të natyrës së mallit (verë), ndëshkimi me gjobë dhe sekuestrimi i mallrave janë masa ligjore të justifikuara. Nëse subjekti pretendon se malli ishte i ligjshëm apo se ndodhej aty për arsye të caktuara, ai duhet të kishte dokumentuar këtë fakt në mënyrë të saktë dhe të plotë. Rezulton i provuar fakti se subjekti është përsëritës, pasi Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.23, me Nr.98/5 Prot., datë 09/03/2026, ka vendosur kontabilizimin e penaltetit doganor në shumën 150,000 (Njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë, ndaj subjektit debitor “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, me banim në Vlorë (Selenicë; Njësia Administrative Armen; fshati Picar, Rruga Bregut, ND.26, Hyrja 1, KP 9409).

Nga analiza e provave administrative të administruara gjatë procedimit rezulton se janë përmbushur të gjithë elementët objektivë të shkeljes doganore të kontrabandës, në kuptim të nenit 266 të Kodit Doganor. Procesverbalet e kontrollit fizik, evidenca e kontrollit fizik, procesverbali për verifikimin e shkeljes doganore, si dhe dokumentacioni shoqërues i administruar në dosjen administrative, përbëjnë prova shkresore të hartuara nga nëpunës publikë gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore dhe gëzojnë forcë provuese deri në kundërshtimin e tyre me prova të ligjshme. Gjatë procedimit administrativ nuk rezulton që



ligjshme të mallit, statusin fiskal të tij apo përmbushjen e detyrimeve për deklarimin doganor dhe fiskal. Për pasojë, autoriteti doganor ka krijuar bindjen e tij mbi bazën e provave objektive dhe të administruara rregullisht në dosje, në respektim të parimit të ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe të vlerësimit të lirë të provave në procedimin administrativ.

Po ashtu, nga verifikimi I dokumentacionit të Degës së Doganës Vlorë rezulton se subjekti ka qenë më parë objekt i një mase administrative për të njëjtën kategori shkeljeje, fakt i cili aktivizon dispozitën e nenit 269, pika 1, të Kodit Doganor mbi përsëritjen (recidivën). Për rrjedhojë, autoriteti doganor ka zbatuar në mënyrë korrekte mekanizmin ligjor të rëndimit të sanksionit administrativ, duke e përcaktuar penaltetin në masën e gjashtëfishit të detyrimit fiskal, në përputhje me nenet 268 dhe 269 të Kodit Doganor.


Për sa më sipër, mbështetur në konkluzionet e evidentuara në Procesverbalin me nr.1876 Prot., datë 29.06.2026, Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH” të ndryshuar, V.K.M–në nr.651 datë 10.11.2017 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014”,

#### V E N D O S A :

- Subjektit “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, t’i sekuestrohet menjëherë malli i pasqyruar në aktet e lartpërmendura, bazuar në nenin 268/1 të Ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014.
- Subjekti “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, të ndëshkohet me gjobë në masën e gjashtëfishit të detyrimit fiskal të papaguar, në shumën 46,416 (dyzet e gjashtëmijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë, bazuar në nenin 269/1 të Ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014.
- Për të proceduar më tej në zbatim të procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore në fuqi ngarkohen Zyra e Operacioneve Doganore, Zyra e Financës, Zyra e Borxhit Doganor, këtu.
- Një kopje origjinale e këtij vendimi t’i jepet zyrtarisht Drejtorisë Vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit Vlorë, si dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për dijeni dhe për marrjen e masave që u takojnë sipas kompetencave ligjore.
- Kundër këtij vendimi, subjektit “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, i lejohet të ushtrojë ankim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr. nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i R.SH” (i ndryshuar).

**K R Y E T A R**

**Artan Bedinaj**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

2326  
Nr..... Prot.

Vlorë, më 05/08/2026

**VENDIM Nr.166**

Sot, më datë 05/08/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L664122020, me seli në Vlorë (Lagjja "Rilindja", Rruga "Riza Salati", Godinë 4 katëshe; me adresë elektronike E-Mail: magsshoes4@gmail.com), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032978, nr.283/4 Prot., datë 18/06/2026, i mbajtur nga ana e Grupit të Kontrollit,

**K O N S T A T O V A S E :**

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.16652/16 Prot., datë 12/03/2026, protokolluar me Tonën me nr.2514/10, datë 13/03/2026, me lëndë "*Dërgimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit*". Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua "Plani i Punës" me nr.2514/11 Prot., datë 30/03/2026, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Rezulton se organi konstatues ka rekomanduar ndaj subjektit "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L664122020, si vijon : "*Në auditim të dosjes të operatorit konstatohet mungesa e dokumenti i mbylljes së regjimit (Aneks 8). Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar dokumentin e mbylljes së regjimit (Aneksi 8) brenda afatit ligjor të parashikuar, në kundërshtim me parashikimet e nenit 550 "Dokumentit i mbylljes së regjimit" i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të kreu XIV/pika 2 dhe kreu XV/pika 1/paragrafi 9, pika 2 dhe 3 të Udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv", i ndryshuar, duke konsumuar kundërvajtje*

*administrative të parashikuar shprehimisht nga neni 252/c i ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit kundërvajtja duhet të duhet të klasifikohet "kundërvajtje në neglizhencë": c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;*

*Për këtë shkelje rekomandohet të aplikohet një gjobë në shumën 50,000 lekë në mbështetje të nenit 257/1/b të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar".*

Për konstatimin e lartcitur, Dega e Doganës Vlorë, bazuar në nenin 41 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", e ka njoftuar subjektin mbi fillimin e procedurës administrative, me anë të shkresës nr.283 Prot., datë 28/01/2026, me lëndë "Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative", me të cilën i ka kërkuar subjektit paraqitjen e të gjithë dokumentacionit, informacionet përkatëse, provat, mendimet, shpjegimet e mundshme, kundërshtimet, propozimet etj, të cilat hedhin dritë mbi veprimet e kryera nga ana Juaj për regjimin doganor të lartpërmendur.

Për marrjen në shqyrtim të rekomandimit të Drejtorisë të Auditit të Brendshëm, Dega e Doganës Vlorë ka vijuar me shkresën Nr.283/1 Prot., datë 20/04/2026, me lëndë "Program kontrolli", me tematikë "Verifikim në magazinën e subjektit i mallrave të importuara me regjimin e përpunimit aktiv Nr.19751/1 prot., datë 07.04.2023".

Në përfundim të kontrollit të ushtruar në ambientet e subjektit "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O, grupi i kontrollit ka mbajtur aktet zyrtare si vijon :

Proces verbal kontrolli fizik / verifikimi me numër serial 0008229, datë 30/04/2026, ora 10:30, me nr.283/2 Prot., datë 30/04/2026, ku në pjesën përshkruese dhe verifikimin e situatës kanë parashtruar si vijon : "Në vijim të Raportit Përfundimtar të Auditit të Brendshëm si dhe Program kontrollit me nr.283/1 prot., datë 20/04/2026, u ushtrua kontroll në ambientet e firmës "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O. Grupi i punës u paraqit pranë ambientit të subjektit dhe u bë e mundur hyrja në magazinë nga roja e subjektit. Gjatë verifikimit u konstatua se subjekti nuk ushtron më aktivitet ekonomik. Gjatë inspektimit fizik u konstatua prania e një sasive të konsiderueshme mallrash, të cilat sipas rrethanave lidhen me autorizimin e përpunimit aktiv të autorizimit me nr.19751/1 prot., datë 07.04.2023. Megjithatë për shkak të mungesës së kushteve dhe mjeteve të nevojshme për kryerjen e

*punimeve në momentin e kontrollit, grupi i kontrollit nuk ishte në gjendje të përcaktonte me saktësi sasinë, peshën e mallrave të konstatuara. Për rrjedhojë e bë vetëm konstatimi fizik dhe vizual i pranisë së mallrave në ambientet e subjektit, në mungesë edhe të përfaqësuesit ligjor të tij”.*

Në përfundim të kontrollit të ushtruar, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shyrtime të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verballi i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032978, Nr.283/4 Prot., datë 18/06/2026, ku në pjesën përshkruese është parashtruar si vijon : *“Referuar Raportit Përfundimtar të Auditit me Nr.16652/16, dt. 12/03/2026, subjekti “MAGS SHOES” sh.p.k, me NIPT L664122020 nuk ka dorëzuar dokumentin e mbylljes Aneksin 8 brenda afateve kohore për Regjimin e Përpunimit Aktiv me nr.19751/1 prot., datë 07/04/2023”.* Ky proces verbal i është njoftuar subjektit me shkresën nr.283/6 Prot., datë 18/06/2026, me lëndë “Njoftim i proces – verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative” i cili është rikthyer në doganë (kod bar RR862131626AA) me shënimin postar “Larguar – mbyllur” dhe më tej, është vijuar me kryerjen e njoftimit publik me shkresat si vijon : Nr.1912 Prot., datë 01/07/2026 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit shkresor” drejtuar Bashkisë Vlorë; Nr.1913 Prot., datë 01/07/2026 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit shkresor administrativ (proces verbalit të shkeljes doganore)” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë; Nr.1914 Prot., datë 01/07/2026 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit shkresor” drejtuar Prefektit të Qarkut Vlorë; të cilët, kanë konfirmuar shpalljen publike përkatëse. Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : *“Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.*

Nga analiza e të gjithë dokumentacionit administrativ të administruar në dosje, e konstatimeve të grupit të auditimit, si dhe e verifikimeve të kryera nga Dega e Doganës Vlorë, rezulton i provuar fakti se nga ana e subjektit nuk është dorëzuar në degën doganore mbikqyrëse Aneksi nr.8 “Dokumenti i mbylljes së autorizimit”, brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230 të Kodit Doganor, edhe pse subjekti është njoftuar nga Dega e Doganës.

Midis të tjerave, në Udhëzimin nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, është parashikuar si detyrim për operatorin ekonomik si vijon *“...Të kryejë një bilanc tre mujor në formën e akt rakordimit në bashkëpunim me doganierin që ndjek regjimin”.*

Subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O, ka kryer shkelje administrative të kryer në neglizhencë, bazuar në nenin 252, pika c) e Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i cili parashikon si vijon : *Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë: c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;*

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.

Për sa më lart, mbështetur në nenet 230, 250/1/a, 252, 257/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv",

#### **V E N D O S A :**

- Subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O të penalizohet në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke garantuar paraprakisht 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

**KRYETAR**  
**Artan Bedinaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 2325 Prot.

Vlorë, më 05/08/2026

**VENDIM Nr.167**

Sot, më datë 05/08/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L664122020, me seli në Vlorë (Lagjja "Rilindja", Rruga "Riza Salati", Godinë 4 katëshe; me adresë elektronike E-Mail: magsshoes4@gmail.com), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032977, nr.283/3 Prot., datë 18/06/2026, i mbajtur nga ana e Grupit të Kontrollit,

**KONSTATOVA SE :**

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.16652/16 Prot., datë 12/03/2026, protokolluar me Tonën me nr.2514/10, datë 13/03/2026, me lëndë "*Dërgimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit*". Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua "Plani i Punës" me nr.2514/11 Prot., datë 30/03/2026, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Rezulton se organi konstatues ka rekomanduar ndaj subjektit "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L664122020, si vijon : "Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e operatorit ekonomik "Mags Shoes" Shpk me NIPT L664122020, të vënë në dispozicion nga Dogana Vlorë rezultoi se operon nën regjimin e përpunimit aktiv i autorizuar për prodhimin e Faqe për veshje këmbë, veshje këmbë të ndryshme sipas autorizimit me nr. 19751/1, datë 07.04.2023. Sistemi i autorizuar - me pezullim; Sasia e vlerësuar – 200,000 palë; Vlera e vlerësuar – 2,000,000 euro. Periudha e vlefshmërisë – 12 muaj; Kufiri kohor për riekспортim – 12 muaj; Mallrat që do të vendosen nën regjimin doganor janë me kod tariforë; 3210, 3505-06, 3815, 3901-10, 3912, 3919-21, 3923, 3926, 4002-08, 4016, 4103-07, 4112-14, 4205,

4304, 4802-14, 4816-19, 4821-23, 4908, 5111, 5204, 5401, 5506-09, 5512-16, 5601-07, 5802-07, 5901-07, 5911, 6001-06, 6117, 6217, 6307, 6406, 7018, 7117, 8306-08, 9606-07, 9612. Produktet kompensues të përfituara nga përpunimi i lëndëve të para do të jenë sipas kodeve tarifor, 6401-06.

Situata/bilanci material i autorizimit sipas sistemit oracle/database kombëtare paraqitet si mëposhtë:

| Nr.                 | Emertimi | Procedura | P. Net | Vl. Fat.  | Tax. Dog |
|---------------------|----------|-----------|--------|-----------|----------|
| a                   | Import 5 | 5100      | 57,722 | 1,216,253 | 545,075  |
| b                   | Import 5 | 5151      | 46,697 | 141,333   | 0        |
| c                   | Export 3 | 3151      | 49,151 | 1,176,884 | 0        |
| d                   | Import 9 | 9351      | 12,566 | 0         | 0        |
| Totalët = (a+b-c-d) |          |           | 42,701 | 180,702   | 545,075  |

Referuar tabelës së mësipërme – bilanci material i autorizimit rezulton me diferenca në sasi, vlerë dhe taksë doganore.

- Në lidhje me vlerën e taksës doganore për të konkluduar nëse ka lindur një borxh doganor importi, kjo referuar pikës XII “Rregulli i pagimit të detyrimeve për shkak të përfitimit të origjinës”, të udhëzimit nr.4, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, i ndryshuar, sipas të cilit mallrat jo origjinuese të trupëzuara në produktet e kompensuese i nënshtrohen pagimit të taksës doganore preferenciale në momentin e rieksporitit u analizuan artikujt që në import 5 kanë gjeneruar taksë doganore dhe eksportet nëse janë pajisur me certifikatë Eur. 1

Nga auditim me përzgjedhje të deklaratave të eksportit të cilat operatori nuk i ka pajisur me certifikatë origjine Eur.1 konstatohet se artikujt jo origjinuese janë eksportuar të pa pajisur me certifikatë origjine Eur.1, si rrjedhojë nuk ka lindur një borxh doganor importi kjo referuar pikës 14 të udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të RPA” dhe pikën XII “Rregulli i pagimit të detyrimeve për shkak të përfitimit të origjinës” të udhëzimit nr.4, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të RPA”, mallrat jo origjinuese të trupëzuara në produktet e kompensuese i nënshtrohen pagimit të taksës doganore preferenciale në momentin e rieksporitit këto produkte kanë përfituar origjinë preferenciale shqiptare.

- Për diferencën (sipas bilancit material të autorizimit), në peshë prej 42,964 kg me vlerë 180,702 euro grupi i auditimit nisur dhe nga gjetja në deklaratën doganore të eksportit, DAV-I me nr. R 5769 datë 25.04.2023 në sasi 362 kg me vlerë 29,856 euro, e cila sipas kartës teknologjike të bashkangjitur në deklaratë, shkarkon mallrat e importuara në Imp. 5, DAV-i me nr. R5546 datë 24.04.2023 me sasi 362 kg dhe vlerë 26,480 euro, pra vlera e eksportit është 3,376 euro më shumë se vlera e mallrave të importuara.

Nisur nga kjo gjetje, grupi i auditimit për efekt të përlllogritjeve të detyrimeve doganore, nuk mund të marrë vlerën e mallrave që rezultojnë në bilancin material të autorizimit, kjo edhe për faktin se:

- Grupi i auditimit nuk mund të përcaktojë llojin e mallrave, që rezultojnë të pa shkarkuara/rieksportuara/dhënie destinacion,
- Vlera mesatare euro/kg në import është 13 euro/kg ndërsa vlera e mallrave të pa rieksportuara/dhënie destinacion është 4.23 euro/kg. (sipas tabelave të mëposhtme)

| Vlera mesatare e mallrave të Importuara. |              |           |            |              |                       |
|------------------------------------------|--------------|-----------|------------|--------------|-----------------------|
| Nr.                                      | Emertimi     | Procedura | P. Net     | Vlera        | Çmimi mesatar Euro/kg |
| a                                        | Imp. 5       | 5100      | 57722.149  | 1216253.49   | 13.00                 |
| b                                        | Imp. 5       | 5151      | 46696.53   | 141333.34    |                       |
| d                                        | Totali (a+b) |           | 104,418.68 | 1,357,586.83 |                       |

| Vlera mesatare e mallrave të pa eksportuara/dhënie destinacion. |        |         |                       |
|-----------------------------------------------------------------|--------|---------|-----------------------|
|                                                                 | P. Net | Vlera   | Çmimi mesatar Euro/kg |
| Mallrat e rieksportuar sipas bilancit material                  | 42,701 | 180,702 | 4.23                  |

Për sa më sipër, grupi i auditimit në pa mundësi për të përcaktuar llojin dhe vlerën e mallrave, për qëllime doganore, ka bërë përlllogaritjet e detyrimeve doganore, duke marrë çmimin mesatar të lëndëve të para të importuara në këtë autorizim. Çmimi mesatar për një kg është 13 euro/kg. (Për efekt të përlllogaritjeve është marrë kursi i këmbimit të periudhës të auditimit Nëntor 2025 që është 96.83 euro/lekë dhe në pa mundësi për të përcaktuar llojin e mallrave gjendje nuk është marrë në konsideratë vlera e taksës doganore që mund të rezultojë e pa rieksportuar). Për diferencën në sasinë 42,701 kg, nga ana e operatorit ekonomik është konsumuar kundërvajtja administrative doganore e parashikuar nga nenet 250/1/"a" dhe 252/"c", të ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të paguhet penalitet në bazë të nenit 257 pika 1/a, të ligjit nr.102/2014 "Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë" rekomandon që operatori "Mags Shoes" Shpk të paguajë penalitet dyfishin e detyrimit.

Përlllogaritja e detyrimeve:

Sasia 42,701 kg \* 13 euro/kg \* 96.83 kursi i këmbimit = 53,757,845 lekë

Detyrimi TVSH = 10,751,569 lekë \* 20% = 10,751,569 lekë

Penalitet, = 10,751,569 \* 2- fishi = 21,503,138 lekë

Totali = 32,254,707 lekë

| Detyrimi Doganor | Penalitet                                                              | Totali          |
|------------------|------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| 10,751,569 lekë  | 21,503,138 lekë 2-fish i detyrimit doganor, neni 257, pika 1/"a" e K.D | 32,254,707 lekë |

Për konstatimin e lartcituar, Dega e Doganës Vlorë, bazuar në nenin 41 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, e ka njoftuar subjektin mbi fillimin e procedurës administrative, me anë të shkresës nr.283 Prot., datë 28/01/2026, me lëndë “Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative”, me të cilën i ka kërkuar subjektit paraqitjen e të gjithë dokumentacionit, informacionet përkatëse, provat, mendimet, shpjegimet e mundshme, kundërshtimet, propozimet etj, të cilat hedhin dritë mbi veprimet e kryera nga ana Juaj për regjimin doganor të lartpërmendur.

Për marrjen në shqyrtim të rekomandimit të Drejtorisë të Auditit të Brendshëm, Dega e Doganës Vlorë ka vijuar me shkresën Nr.283/1 Prot., datë 20/04/2026, me lëndë “Program kontrolli”, me tematikë “Verifikim në magazinën e subjektit i mallrave të importuara me regjimin e përpunimit aktiv Nr.19751/1 prot., datë 07.04.2023”.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar në ambientet e subjektit “MAGS SHOES” sh.p.k, me NIPT L66412202O, grupi i kontrollit ka mbajtur aktet zyrtare si vijon :

Proces verbal kontrolli fizik / verifikimi me numër serial 0008229, datë 30/04/2026, ora 10:30, me nr.283/2 Prot., datë 30/04/2026, ku në pjesën përshkruese dhe verifikimin e situatës kanë parashtruar si vijon : “Në vijim të Raportit Përfundimtar të Auditit të Brendshëm si dhe Program kontrollit me nr.283/1 prot., datë 20/04/2026, u ushtrua kontroll në ambientet e firmës “MAGS SHOES” sh.p.k, me NIPT L66412202O. Grupi i punës u paraqit pranë ambientit të subjektit dhe u bë e mundur hyrja në magazinë nga roja e subjektit. Gjatë verifikimit u konstatua se subjekti nuk ushtron më aktivitet ekonomik. Gjatë inspektimit fizik u konstatua prania e një sasive të konsiderueshme mallrash, të cilat sipas rrethanave lidhen me autorizimin e përpunimit aktiv të autorizimit me nr.19751/1 prot., datë 07.04.2023. Megjithatë për shkak të mungesës së kushteve dhe mjeteve të nevojshme për kryerjen e punimeve në momentin e kontrollit, grupi i kontrollit nuk ishte në gjendje të përcaktonte me saktësi sasinë, peshën e mallrave të konstatuara. Për rrjedhojë e bë vetëm konstatimi fizik dhe vizual i pranisë së mallrave në ambientet e subjektit, në mungesë edhe të përfaqësuesit ligjor të tij”.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shqyrtim të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verbal i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032977, Nr.283/3 Prot., datë 18/06/2026, ku në pjesën përshkruese është parashtruar si vijon : “Referuar program kontrollit me nr.283/1 datë 20.04.2026 dhe Raportit Përfundimtar të Auditit të Brendshëm lidhur me gjendjen e mallrave të autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv me nr.1975/1 datë 07.4.2023, referuar dhe raportit Oracle

se subjekti "Mags Shoes" ka gjendje të parieksportuar në sasinë prej 42,701 kg, Nisur nga këto kushte është konsumuar kundrvajtje administrative sipas nenit 251/1/a dhe 252/c të Kodit Doganor".

Ky proces verbal i është njoftuar subjektit me shkresën nr.283/5 Prot., datë 18/06/2026, me lëndë "Njoftim i proces – verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative" i cili është rikthyer në doganë (kod bar RR862131626AA) me shënimin postar "Larguar – mbyllur" dhe më tej, është vijuar me kryerjen e njoftimit publik me shkresat si vijon : Nr.1912 Prot., datë 01/07/2026 me lëndë "Kërkesë për shpallje publike të aktit shkresor" drejtuar Bashkisë Vlorë; Nr.1913 Prot., datë 01/07/2026 me lëndë "Kërkesë për shpallje publike të aktit shkresor administrativ (proces verbalit të shkeljes doganore)" drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë; Nr.1914 Prot., datë 01/07/2026 me lëndë "Kërkesë për shpallje publike të aktit shkresor" drejtuar Prefektit të Qarkut Vlorë; të cilët, kanë konfirmuar shpalljen publike përkatëse.

Nga analiza e të gjithë dokumentacionit administrativ të administruar në dosje, e konstatimeve të grupit të auditimit, si dhe e verifikimeve të kryera nga Dega e Doganës Vlorë, rezulton i provuar fakti se subjekti nuk i ka dhënë destinacion sasive të mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv brenda afateve të përcaktuara në autorizim, duke mos realizuar njëkohësisht edhe mbylljen e regjimit doganor sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : "Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ".

Neni 252 shkronja "c" parashikon si vijon : Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë : c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28; Ndërsa në nenin 257, 1/a kemi : 1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm : a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar;

Nga shqyrtimi në tërësi i materialit administrativ të administruar në dosje, të raportit përfundimtar të auditimit, të procesverbaleve të kontrollit dhe të verifikimit të kundërvajtjes administrative, si dhe të gjithë dokumentacionit shoqërues, rezulton se subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k. ka qenë mbajtës i autorizimit për regjimin doganor të përpunimit aktiv nr.19751/1, datë 07.04.2023, autorizim nga i cili burojnë detyrime të qarta ligjore për administrimin e mallrave të vendosura nën këtë regjim, mbajtjen e evidencave, përpunimin e tyre dhe dhënien e një destinacioni të lejuar doganor brenda afatit të autorizuar.

Nga analiza e bilancit material të autorizimit, të dhënave të sistemit Oracle, si dhe verifikimeve të kryera nga organet doganore, rezulton se për një sasi prej 42,701 kg mallrash të importuara nën regjimin e përpunimit aktiv nuk provohet rieksporimi, vendosja në një regjim tjetër doganor, shkatërrimi, braktisja në favor të shtetit apo ndonjë formë tjetër e mbylljes së rregullt të regjimit doganor, sipas kërkesave të Kodit Doganor dhe akteve nënligjore në fuqi.

Në këtë kuadër, edhe pse gjatë kontrollit fizik të ushtruar në ambientet e subjektit u konstatua prania e një sasive mallrash, grupi i kontrollit evidentoi se, për shkak të mungesës së përfaqësuesve të subjektit, mungesës së dokumentacionit shoqërues dhe pamundësisë objektive për kryerjen e inventarizimit të plotë në momentin e kontrollit, nuk ishte e mundur të përcaktohej identiteti, pesha dhe korrespondenca e këtyre mallrave me diferencat e konstatuara në bilancin material të autorizimit. Për rrjedhojë, ky konstatim fizik nuk përbën provë të mjaftueshme për të rrëzuar gjetjet e auditimit apo për të provuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga autorizimi.

Nga ana tjetër, subjekti është njoftuar rregullisht për fillimin e procedurës administrative, duke iu krijuar mundësia të paraqiste dokumentacionin, provat dhe shpjegimet që do të provonin destinacionin doganor të mallrave ose pasaktësinë e konstatimeve të auditimit. Megjithatë, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues, nuk ka bashkëpunuar me administratën doganore dhe nuk ka ushtruar të drejtën e tij procedurale për të kundërshtuar në mënyrë të argumentuar gjetjet e administratës doganore. Edhe procesverbali i verifikimit të kundërvajtjes administrative nuk mundi t'i njoftohej në mënyrë të drejtpërdrejtë për shkak se subjekti rezultoi i larguar nga adresa e deklaruar, ndaj administrata procedoi me njoftimin publik, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, duke garantuar respektimin e së drejtës së subjektit për t'u njohur me procedurën.

Në mungesë të provave që të dokumentojnë mbylljen e rregullt të regjimit doganor ose destinacionin e ligjshëm të mallrave, administrata doganore vlerëson se mbetet i vlefshëm konstatimi i auditimit, sipas të cilit ekziston një diferencë materiale prej 42,701 kg mallrash të pajustificuara në bilancin e autorizimit.

Gjithashtu, autoriteti doganor vendimmarrës vlerëson se metoda e përdorur nga grupi i auditimit për përlogaritjen e detyrimeve doganore është objektivist e justifikuar. Duke qenë se nuk ishte e mundur të identifikohesh lloji konkret i mallrave që rezultojnë të pambyllura në regjim dhe, rrjedhimisht, as vlera individuale e tyre, përlogaritja është bazuar në çmimin mesatar të mallrave të importuara në kuadër të autorizimit, duke përdorur të dhënat objektive të sistemit doganor dhe kursin zyrtar të këmbimit të periudhës së auditimit. Kjo metodologji shmang arbitraritetin dhe garanton një vlerësim të bazuar në elemente të verifikueshme.

Në këto kushte, provohet se subjekti nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin nga autorizimi për regjimin e përpunimit aktiv dhe nga legjislacioni doganor, duke mos siguruar mbylljen e regjimit për mallrat e importuara dhe duke mos provuar destinacionin e tyre doganor. Ky mosveprim përbën mosrespektim të detyrimeve të vendosura me vendimin e autorizimit, në kuptim të nenit 252, shkronja "c", të Kodit Doganor.

Për më tepër, mosmbyllja e regjimit doganor ka sjellë si pasojë lindjen e detyrimit për pagesën e TVSH-së për mallrat që rezultojnë të pambyllura në regjim, ndërsa në përputhje me nenin 257, pika 1, shkronja "a", të Kodit Doganor, kur kundërvajtja sjell diferenca në pagesën e detyrimeve doganore, sanksioni administrativ caktohet në masën dyfish të detyrimit të munguar. Duke qenë se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të kundërvajtjes administrative, autoriteti doganor vendimmarrës çmon se janë plotësisht të bazuara ligjërisht kushtet për vendosjen e sanksionit administrativ të parashikuar nga kjo dispozitë.

Në përfundim, mbi bazën e provave të administruara gjatë procedurës administrative, të cilat janë vlerësuar në mënyrë të gjithanshme, objektive dhe në përputhje me parimin e ligjshmërisë, rezulton se rekomandimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, gjetjet e grupit të kontrollit dhe procesverbali i verifikimit të kundërvajtjes administrative mbështeten në prova të mjaftueshme dhe krijojnë bindjen e plotë administrative se subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k. ka konsumuar kundërvajtjen administrative të

parashikuar nga nenet 250, 252, shkronja "c", dhe 257, pika 1, shkronja "a", të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimin Nr.4 datë 28.03.2019 "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv",

#### **V E N D O S A :**

- Subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **10,751,569** (Dhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O të penalizohet në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën **21,503,138** (Njëzet e një milionë e pesëqind e tre mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Mbikqyrjes Doganore të procedojë me mundësimin dhe vënien e mallrave përkatës në regjimin doganor të duhur, konform përcaktimeve të legjislacionit doganor për regjimin në fjalë.
- Kundër këtij vendimi, subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k., me NIPT L66412202O, ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ të arsyetuar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni për këtë vendim, në përputhje me nenin 282 të Ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", si dhe duke plotësuar kushtëzimet e këtij neni.

**KRYETAR**  
**Artan Bedinaj**

